



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2023, merr këtë

**V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR “PRO- ARTE INSTITUTE”**

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për “PRO-ARTE Institute”.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 4,900.00 € (katër mijë e nëntëqind euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II për PRO - ARTE Institute, i cili përmes festivalit “GRAN Fest”, synon të nxjerrë në gjuhën angleze romanin grafik *Kthimi në Kosovë*, roman ky i botuar në origjinal në gjuhën franceze, me titullin “Retour au Kosovo”, González- Jakupi, éd. Dupuis 2014.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-451/01-86560/23, më 02.05.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



A r y e t i m
Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Pro - ARTE Institute

PRO - ARTE Institute përfaqësuar nga Gani Jakupi më, 14.03.2023, ka parashtruar kërkesë me shkrim tek kryetari i Komunës për mbështetje financiare, me të cilën synon të nxjerrë në gjuhën angleze romanin grafik *Këthimi në Kosovë*, roman ky i botuar në origjinal në gjuhën franceze me titullin *Retour au Kosovo*, González- Jakupi, éd. Dupuis 2014, ky roman është i botuar në gjuhën spanjolle, italiane, ruse dhe polake, njëkohësisht edhe në atë serbe, të financuar nga Goeth Institute.

Në kërkesën e tij z. Jakupi ka përkthuar edhe koston e projektit si në vijim:

- Shtypja: 2,200 €,
- Licenca: 800 €,
- Përkthimi, lekturimi: 650 €,
- Thyerja grafike dhe kaligrafimi: 500 €,
- Kosto e menaxhimit të projektit: 300 €,
- Promocioni dhe shpërndarja: 450 €.

Totali i gjithë projektit 4.900 €.

Gjithashtu në kërkesën e tij z. Jakupi thekson se nga kopjet e shtypura gjysma e kopjeve do t'iu lihen në dispozicion Kuvendit Komunal të Komunës dhe MPJD-së për reprezentacion ndërkombëtar.